

VENDIM
Nr.19, datë 29.4.2004

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
SHOQËRIA "EMIHEL" SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, bordi i komisionarëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "EMIHEL" sh.p.k për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria "EMIHEL" sh.p.k. për periudhën 1.1.2004 - 31.12.2004 të jetë 4,3 lekë/kWh.
2. Ngarkohet shoqëria "EMIHEL" sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Pjetër Dema